



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME
Nr.01-060/01-2466/24 datë:22.01.2024



Npi – 01/46 datë: 31.01.2024

Bazuar në nenin 58 pikat (g, h) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28/2008); Nenin 7 të Ligjit për Policinë e Kosovës Nr.04/L-076; Nenin 3 të Udhëzimit Administrativ Nr.27/2012 të (MPB) dhe U.A-03/2012 të (MAPL), për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi. Si dhe në bazë të Vendimit të Kuvendit të Komunës së Shtimes Npi – 01/291, datë:27.09.2022, për themelimin e Komisionit Komunal për Siguri në Bashkësi, Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e mbajtur më: 31.01.2024, miratoi këtë:

V E N D I M

PËR MIRATIMIN E RAPORTIT TË PUNËS TË KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI PËR VITIN 2023

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e -I- të rregullt për vitin 2024, të mbajtur më: 31.01.2024, unanimisht miratoi, Raportin vjetor të punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, në Komunën e Shtimes për vitin 2023.

II

Kuvendi i Komunës ka marrë për bazë edhe rekomandimin nga Komiteti për Politikë dhe Financa.

III

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale, si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb. faqen e Komunës së Shtimes.

IV

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Kordinatorit të KKSB-së, Drejtorive, Kryetarit të Komunës, Ministrisë të Administrimit të Pushteti Lokal, dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesi i Kuvendit
Adnan Ademi